



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:264302

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05873855

KPPP.nr. 2042/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina" Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. "Hazir Shala", nr. 4., kundër debitorit "Dardi" SH.P.K., me numër unik identifikues 600994950 " me seli në Prishtinë, rr "Dëshmorët e Kombit" duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr. 333/23, i lejuar me datë 06.10.2023, nga Përmbareuesi Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 28.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Sallon "Dardi" SH.P.K., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 333/23, i lejuar me datë 06.10.2023, nga Përmbareuesi Privat Flamur S. Bogaj, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina" Sh.A., me datë 06.10.2023 ka lëshuar urdhrin përmbaremore P.nr. 333/23, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit Ekstraktit nga librat afarist me shifrën 1740, ashtu që është detyruar debitori që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, në emër të borxhit të papaguar për shërbimet e furnizimit me ujë, t'ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 419.86€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori, brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbaremit me arsyetim se ka përmbushur në tërësi borxhin ndaj kreditorit, ashtu që urdhri për përmbaremin është i pa bazuar, pasi që kreditori nuk ka bashkangjitur faturat si dokument i besueshëm. Po ashtu ka

shtuar se borxhi është parashkruar. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar dhe të anuloj urdhrin përmbarimor.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se të njëjtat janë të pa bazuara dhe pa argumentuara në ligj dhe prova. Ka shtuar se sa i përket pretendimet të debitorit për parashkrim, borxhi nuk është parashkruar pasi që debitori ka ndërprerë parashkrimin me rastin e kryerjes së pagesave ndaj kreditorit. Tutje ka theksuar se ekstrakti nga librat afarist është dokument i besueshëm andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Ekstrakt nga librat afarist me shifrën 1740, mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarim, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit dhe nuk është përfshirë periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit.

Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që ekstrakti nr.1740 përfshin periudhën kohore nga 01.01.2013 e deri më datë 06.10.2023 në shumë prej 419.86€, ndërsa në përmbajtjen e ekstraktit, janë të listuara faturat vetëm nga data 31.12.2013 e tutje, ashtu vlera e borxhit prej 389.95€, e paraqitur si saldo, nuk dihet se për cilën periudhë kohore është grumbulluar dhe a është njoftuar debitori lidhur me këtë detyrim.

Prandaj, në formën e paraqitur, ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Meqenëse gjykata gjeti se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të tjera të ngritura nga debitori si në prapësim, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2042/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.